**VENDIM**
**Nr. 10, datë 9.1.2025**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 921, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 3, 8, 14, 15, pika 3, shkronja "dh", pika 4, shkronja "ç", pika 5, shkronja "dh", pika 6, shkronja "d", pika 7, shkronja "dh", pikat 9, 11 e 12, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun VIII/1, të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "b", të pikës 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Paragrafi i dytë, i nënndarjes "i", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Përveç përgjegjësive të parashikuara në legjislacionin doganor, drejtori i përgjithshëm i Doganave miraton planin operacional dhe strategjinë e biznesit të administratës doganore, si dhe dokumentet e tjera në kompetencë të tij; propozon, pranë ministrit përgjegjës për financat, strukturën organizative, rregulloret e brendshme të administratës doganore e projektaktet dhe adreson përgjegjësitë në të gjitha nivelet e administratës, në varësi të nevojave apo të rrethanave specifike.".

b) Në nënndarjen "iv", emërtesa "kryetar i Degës Doganore Fier" hiqet.

2. Në pikën 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "a" bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

i. Në fund të paragrafëve të nënndarjes "i" shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"- menaxhimin dhe ndjekjen e marrëdhënieve me masmedian dhe me komunitetin e biznesit;

- përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të programeve të publikimit të çdo risie në sistemin doganor, në bashkëpunim me strukturat teknike dhe koordinatorin për të drejtën e informimit.".

ii. Në nënndarjen "iii" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Emërtimi "Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë" zëvendësohet me "Drejtoria e Integrimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve";

b) Nënndarja "- Ndjek e menaxhon marrëdhëniet me masmedian dhe me komunitetin e biznesit, si dhe përgatit e ndjek zbatimin e programeve të publikimit të çdo risie në sistemin doganor", shfuqizohet;

iii. Paragrafi i fundit i nënndarjes "iv", shfuqizohet;

iv. Në fund të nënndarjes "v" shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale asiston Koordinatorin kundër Korrupsionit gjatë kryerjes së hetimeve për çështje antikorrupsioni.".

v. Nënndarja "vi" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"vi. Drejtoria e Apelimit, Ankimimeve Doganore dhe Përafrimit me Bashkimin Evropian, që përbëhet nga:

- sektori i apelimit/ankimimit;
- sektori i përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Evropian.

Sektori i apelimit/ankimimit shqyrton ankimet administrative ndaj vendimeve të degëve doganore në lidhje me pagesën e detyrimeve dhe/ose gjobave dhe ia paraqet për vendimmarrje

drejtorit të përgjithshëm të Doganave. Ndjek proceset gjyqësore, ku palë është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në bashkëpunim me strukturat përkatëse teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, asiston për përfaqësimin në proceset gjyqësore, ku palë janë vetëm degët doganore, në rastet kur kërkohet prej tyre, lidhur me vendimmarrje të drejtorit të Përgjithshëm.

Sektori i përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Evropian, në përputhje me misionin e autoriteteve doganore, ndjek planin e përafrimit të legjislacionit doganor/akcizës me atë të Bashkimit Evropian. Jep mendim për propozimet e strukturave përkatëse teknike për çështje të përafrimit të legjislacionit në fushën doganore apo të akcizës. Jep mendim në bashkëpunim me strukturat e tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për projektaktet e propozuara nga institucionet e tjera që lidhen me veprimtarinë doganore.".

vi. Nënndarja "vii" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"vii. Drejtoria e Statistikës, Pagesave, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit, që përbëhet nga:

- sektori i statistikës dhe analizës së të ardhurave;
- sektori i monitorimit të borxhit dhe bashkëpunimit me tatimet;
- sektori i pagesave, të ardhurave dhe garancive.

Sektori i statistikës dhe analizës së të ardhurave ka këto detyra:

- Mbledh të dhëna për lëvizjen e mallrave, që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;
- Monitoron e detajon planin e të ardhurave;
- Analizon të dhënat, objekt të vlerësimit nga zyrat e interesuara dhe autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke e zgjeruar fushën e përgjegjësive edhe me studime e analiza të realizimit të të ardhurave dhe mallrave kryesore.

Sektori i monitorimit të borxhit dhe bashkëpunimit me tatimet ka këto detyra:

- Administron procedurat për regjistrimin e operatorëve në sistemin doganor, lindjen dhe rikuperimin e borxhit, përgatitjen dhe administrimin e udhëzimeve për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit, eksportit ose akcizës, për vjeljen e detyrimeve dhe rimbursimin ose shlyerjen e borxhit, si dhe monitoron procedurat për vjeljen e borxhit e rikuperimin me forcë;
- Bashkëpunon me strukturat tatimore, sipas marrëveshjeve në fuqi;
- Përgatit raporte, analiza, studime, analizon dhe vlerëson informacionet e ndryshme, që merr nga strukturat tatimore dhe/ose doganore dhe propozon ndërtimin e profileve të reja të riskut etj.

Sektori i pagesave, të ardhurave dhe garancive ka këto detyra:

- Ndjek, kontrollon e monitoron të gjitha pagesat në sistem, përgatit procedurat e kreditimit të pagesave dhe të kontrollit të tyre me bankat e thesarin;
- Monitoron pagesat hyrëse në sistemin *Asycuda World*, që të bëhen në mënyrë standarde;
- Siguron që pagesat të bëhen në numrin e llogarisë që i përket shoqërisë;
- Ndjek dhe evidenton të gjitha pasaktësitë e arkëtarëve të degëve doganore lidhur me pagesat hyrëse në sistem;
- Administron rregullat e procedurat e dhënies së garancive doganore dhe të akcizës, të monitorimit e të zhbllokimit të tyre;
- Përgatit raportet përkatëse lidhur me shumat e kredituara në sistemin *Asycuda World* gjatë periudhës dhe bën përpunimin e këtyre raporteve;
- Përgatit informacionin përfundimtar lidhur me krahasimin e shumave të kredituara në sistem me ato të marra nga thesari dhe të dhënat e dërguara nga çdo degë doganore;

- Siguron që të marrë periodikisht nga ministria përgjegjëse për financat, në format elektronik, dhe në periudha njëmujore informacion të detajuar nga thesari lidhur me pagesat e bëra, për shkak të veprimtarisë doganore.".

b) Në shkronjën "b" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. Emërtesa "Departamenti Administrativ" zëvendësohet me "Departamenti Ekonomik dhe i Burimeve Mbështetëse".

ii. Në nënndarjen "i" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, nënndarja " - zyra e sekretari/protokollit dhe arkivit" shfuqizohet;

b) Në paragrafin e dytë, fjalët "... dhe administron arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" shfuqizohen;

iii. Në nënndarjen "ii" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Emërtesa "Drejtoria e Burimeve Mbështetëse" zëvendësohet me "Drejtoria e Aseteve dhe e Shërbimeve Mbështetëse";

b) Pas nënndarjes "- Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit *(help desk)*" shtohet nënndarja "- zyra e sekretari/protokollit dhe arkivit.";

c) Pas paragrafit të fundit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Zyra e sekretari/protokollit dhe arkivit administron shërbimin e sekretari/protokollit dhe arkivin e DPD-së.".

iv. Nënndarja "iii" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"iii. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, që përbëhet nga:

- sektori i planifikimit dhe monitorimit të buxhetit;
- sektori i financës dhe kontabilitetit;

Sektori i planifikimit dhe monitorimit të buxhetit është përgjegjës, për:

- zbatimin e legjislacionit e të procedurave, që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe buxhetin e financave publike, organizimin e punës në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm të institucionit, hartimin e pasqyrave përmbledhëse të projektbuxhetit, si dhe për detajimin e planit të buxhetit të miratuar nga ministria përgjegjëse për financat për aparatin e drejtorisë dhe degët doganore;
- hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit dhe raportimin e tyre pranë ministrisë përgjegjëse për financat brenda afateve të përcaktuara;
- rakordimin me ministrinë përgjegjëse për financat të fondeve buxhetore të planifikuara e të realizuara.

Sektori i financës dhe kontabilitetit është përgjegjës, për:

- monitorimin rregullisht të transfertave nga gjobat në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përdorimin e tyre për pjesën e shpenzimeve operative dhe investime, si dhe fondin për shpërblimin nga gjobat në përputhje me Kodin Doganor e udhëzimet përkatëse për këtë qëllim;
- kryerjen e analizave financiare dhe të bilancit, mbajtjen e kontabilitetit, shpërndarjen e dhënien e fondeve të nevojshme për funksionimin e zyrave qendrore e vendore, pagimin e personelit doganor dhe administrimin e pagave e të shpërblimeve të tjera shtesë të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- ndjekjen e përgatitjes së raportimeve periodike për kreditë dhe debitë e trashëguara.".

c) Në nënndarjen "i", të shkronjës "dh", bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. Në paragrafin e pestë, fjalët "... pas zhdoganimit *(a posterior)* ..." zëvendësohen me "... dhe mbikëqyrjen ...";

ii. Në paragrafin e shtatë, pas fjalëve "... lidhur me analizën e riskut ..." shtohen fjalët "... kontrollet pas zhdoganimit *(a posterior)*, ...".

II. Kudo në vendim, emërtesa "Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit" zëvendësohet me "Koordinatori kundër Korrupsionit".

III. Aneksi nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**ANEKSI NR. 1**

| Emërtimi i postit | | Funksioni | Kategoria | Nr. i punonjësve | Klasa e pagës |
|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e drejtorit të përgjithshëm | | Drejtor i përgjithshëm | I | 1 | I-3 |
| | | Koordinator kundër korrupsionit | II | 1 | II-1 |
| | | Drejtor kabineti | A | 1 | II-1 |
| | | Këshilltar | A | 4 | II-2 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| **Totali Zyrës së drejtorit të përgjithshëm** | | | | **8** | |
| **Drejtoritë në varësi të drejtorit të përgjithshëm** | | | | | |
| **Drejtoria e Integrimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Koordinimeve dhe Projekteve** | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Integrimit Evropian** | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| **Totali drejtorisë** | | | | **6** | |
| **Drejtoria Auditit të Brendshëm** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-2 |
| | | Auditues | C1 | 7 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **8** | |
| **Drejtoria e Antikorrupsionit & Standardeve Profesionale** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **5** | |
| **Drejtoria e Statistikës, Pagesave, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori Statistikës dhe Analizës së të Ardhurave** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| | **Sektori i Monitorimit të Borxhit dhe Bashkëpunimit me Tatimet** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Pagesave, të Ardhurave dhe Garancive** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 6 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **15** | |
| **Drejtoria e Apelimit, Ankimimeve Doganore dhe Përafrimit me BE** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | **Sektori i Përafrimit të Legjislacionit me BE** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Sektori i Apelimit/Ankimimit** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 9 | IV-1 |
| **Totali Drejtorisë** | | | | **17** | |
| **Totali i zyrës dhe i drejtorive në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm** | | | | **59** | |
| **Departamenti Teknik** | | | | | |
| **Departamenti Teknik** | | Zëvendësdrejtor i përgjithshëm | II | 1 | II-1 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| **Totali** | | | | **2** | |
| **Drejtoria e Procedurave Doganore** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori Procedurave dhe Regjimeve Doganore** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Sektori i Lehtësive Doganore** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| **Totali Drejtorisë** | | | | **10** | |
| **Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 7 | IV-1 |
| | **Sektori i Origjinës** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **14** | |
| **Drejtoria e Laboratorit Doganor** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Administratë** | Sanitar/punonjës pastrimi | D3 | 1 | |
| | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | **Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit** | Përgjegjës Sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Analizave** | Përgjegjës Sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 6 | IV-1 |
| | | Asistent laborant | C2 | 6 | IV-2 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **20** | |
| **Drejtoria e Vlerësimit në Qendër** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Vlerës në Qendër** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Përgjegjës turni | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 30 | IV-2 |
| | **Sektori i vlerësimit doganor dhe të dhënave të disponueshme** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **40** | |
| **Totali i Departamentit Teknik** | | | | **86** | |
| **Departamenti i Akcizës** | | | | | |
| **Departamenti i Akcizës** | | Zëvendësdrejtor i përgjithshëm | II | 1 | II-1 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Përpunues Informacioni | C3 | 1 | |
| **Totali** | | | | **2** | |
| **Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Pijeve Alkoolike** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Sektori i Produkteve Energjetike** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | | Specialist | C2 | 4 | IV-2 |
| | **Sektori i duhanit dhe Produkteve të tjera** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Sektori i Pajisjeve Matëse dhe Linjave Teknologjike** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **25** | |
| **Drejtoria Teknike e Akcizës** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Aplikacioneve** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| | **Sektori i Autorizimeve** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **8** | |
| **Totali i Departamentit të Akcizës** | | | | **35** | |
| **Departamenti Operativo-Hetimor** | | | | | |
| **Departamenti Operativo-Hetimor** | | Zëvendësdrejtor i përgjithshëm | II | 1 | II-1 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| **Totali** | | | | **2** | |
| **Drejtoria e Antikontrabandës** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Antikondrabandës Tokësore** | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | | Komandante grupi | C1 | 18 | IV-1 |
| | | Inspektor Antikontrabande | C2 | 28 | IV-2 |
| | | Doganier pike kontrolli | C3 | 8 | |
| | **Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Antikondrabandës Detare** | Komandant grupi | C1 | 4 | IV-1 |
| | | Specialist inxhinier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionele Detare | C1 | 6 | IV-1 |
| | | Inspektor | C2 | 8 | IV-2 |
| | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | | Teknik marine/motorist | D1 | 4 | |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **83** | |
| **Drejtoria Antitrafik** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Kontrollit të Deklarimeve CASH** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Mallrave të Rrezikshme, Dual Use, Trafiqeve të Paligjshme** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| | **Sektori Operativ Antitrafik** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Komandant grupi | C1 | 2 | IV-1 |
| | | Specialist | C2 | 4 | IV-2 |
| | **Njësia e Pasagjerit** | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Specialist/Koordinator për Skanimin** | Specialist | C1 | 1 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **20** | |
| **Drejtoria e Hetimit** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| | **Sektori i Hetimit Doganor** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist me atribute Oficer i Policisë Gjyqësore | C1 | 17 | IV-1 |
| | **Sektori i Koordinimit dhe Analizave** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **24** | |
| **Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **5** | |
| **Drejtoria e Kontrollit pas Zhdoganimit (Aposterior)** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Kontrollit të Tarifës, Origjinës dhe Vlerës** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 5 | IV-1 |
| | **Sektori i Kontrollit të Regjimeve Doganore** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 5 | IV-1 |
| **Totali Drejtorisë** | | | | **13** | |
| **Drejtoria e Informacionit** | | Drejtor Drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | | Përfaqësues në SECI | A | 1 | VKM 324/2023 |
| | **Sektori Inteligjencës Operative** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 10 | IV-1 |
| | **Sektori i Shkëmbimit/Përpunimit të Informacionit me strukturat homologe** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 7 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **21** | |
| **Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist | C1 | 3 | IV-1 |
| | **Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-1 |
| | | Specialist të monitorimit | C1 | 12 | IV-1 |
| | | Specialist analize risku | C1 | 8 | IV-1 |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | **26** | |
| **Totali i Departamentit Operativo-Hetimor** | | | | **194** | |
| **Departamenti Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse** | | | | | |
| **Departamenti Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse** | | Zëvendësdrejtor i përgjithshëm | II | 1 | II-1 |
| | | Përpunues informacioni | C3 | 1 | |
| **Totali** | | | | **2** | |
| **Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-2 |
| | **Sektori i Menaxhimit të Burimeve** | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Njerëzore** | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | **Sektori i Trajnimeve dhe Etikës** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| **Totali Drejtorisë** | | | | | 9 | |
| **Drejtoria e Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse** | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-2 |
| | **Sektori i Investimeve & Logjistikës** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 4 | IV-1 |
| | | | Teknik mirëmbajtjeje | D1 | 1 | |
| | | | Teknik mirëmbajtjeje (ofiçina) | D1 | 2 | |
| | | | Shofer | D1 | 8 | |
| | | | Sanitar/punonjës pastrimi | D3 | 4 | |
| | **Sektori i Prokurimit** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori Zgjidhjeve dhe Suportit *Help Desk*** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 5 | IV-1 |
| | **Zyra e Sekretari/Protokollit dhe Arkivit** | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/Protokolli | C3 | 2 | |
| | | | Arkivist | C3 | 2 | |
| **Totali Drejtorisë** | | | | | 35 | |
| **Drejtoria e Buxhetit dhe Financës** | | | Drejtor drejtorie | A | 1 | II-1 |
| | **Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | **Sektori i Financës dhe Kontabilitetit** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | | Specialist | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Magazinier | D1 | 2 | |
| **Totali i Drejtorisë** | | | | | 9 | |
| **Totali i Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse** | | | | | 55 | |
| **TOTALI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE (DPD)** | | | | | 429 | |
| | | | | | | |
| **DEGËT DOGANORE** | | | | | | |
| **Dega Doganore Shkodër** | | | Kryetar dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist aposterior/analize risku | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Sektori i Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës i Sektorit të Operacioneve Doganore | B | 1 | III-2 |
| | | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës Zyra e Mbikëqyrjes | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 4 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Shkodër** | Përgjegjës zyre/turni – Shkodër | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 1 | |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Hani i Hotit** | Përgjegjës zyre – Hani i Hotit | C1 | 3 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Bajzë/Tuz** | Përgjegjës zyre – BajzëeTuz | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 4 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Murriqan** | Përgjegjës zyre – Murriqan | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Vermosh** | Përgjegjës zyre –Vermosh | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Grabon** | Përgjegjës zyre – Grabon | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Shkodër** | | | | | 48 | |
| **Dega Doganore Lezhë** | | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Lezhë** | | | | | 15 | |
| **Dega Doganore Bllatë (Peshkopi)** | | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist analize risku/aposterior/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Bllatë (Peshkopi)** | | | | | 14 | |
| **Dega Doganore Kukës (Morinë)** | | | Kryetar dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Sektori i Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës sektori – Operacione Doganore | B | 1 | III-2 |
| | | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës i Zyrës së Mbikëqyrjes | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Morine** | Përgjegjës zyre – Morinë | C1 | 3 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pikë kontrolli | C3 | 6 | |
| | | | Doganier | C2 | 9 | IV-2 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Zyra e Skanerit** | Përgjegjës zyre | C1 | 0 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore Qafëprush** | Përgjegjës zyre – Qafëprush | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | **Zyra Doganore Shishtavec** | Përgjegjës zyre – Shishtavec | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | **Zyra Doganore QafëMorinë Tropojë** | Përgjegjës i Zyrës Qafëmorinë Tropojë | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| **Totali i Degës Doganore Kukës (Morinë)** | | | | | **47** | |
| **Dega Doganore Aeroporti i Kukësit** | | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist analize risku/aposterior/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra operacionale/Terminal** | | Përgjegjës turni | C1 | 3 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 12 | IV-2 |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore/Cargo** | | Përgjegjës zyre/turni | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Aeroporti i Kukësit** | | | | | **23** | |
| **Dega Doganore Tiranë** | | | Kryetar dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës dhe Shërbimit** | | Specialist aposterior/analize risku | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Specialist borxhi | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Specialist jurist | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist finance i nivelit të dytë | C2 | 1 | IV-2 |
| | | | Sekretar | C3 | 1 | |
| | | | Arkivist | C3 | 2 | |
| | | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | **Sektori i Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës Sektori Operacione Doganore | B | 1 | III-2 |
| | | **Zyra e Akcizës Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier akcize | C2 | 8 | IV-2 |
| | | **Zyra e Regjimeve Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier regjimesh | C2 | 9 | IV-2 |
| | | **Zyra e Pikës së Hyrje-Daljes** | Përgjegjës zyre peshoreje/pike kontrolli | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 8 | |
| | | **Zyra Operacioneve Doganore** | Përgjegjës zyre operacionet doganore | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 12 | IV-2 |
| | | **Zyra e Magazinimit të Përkohshëm** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Tiranë** | | | | | **58** | |
| **Dega Doganore Durrës** | | | Kryetar Dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist aposterior/analize risku | C1 | 3 | IV-1 |
| | | | Specialist/borxhi | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Specialist/jurist | C1 | 3 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist finance i nivelit të dytë | C2 | 1 | IV-2 |
| | | | Sekretar | C3 | 1 | |
| | | | Arkivist | C3 | 2 | |
| | | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | **Sektori i Operacioneve Doganore** | | Përgjegjës Sektori i Operacioneve Doganore | B | 1 | III-2 |
| | | **Zyra e Kontrollit** | Përgjegjës i Zyrë së Pikës së Kontrolli | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 10 | |
| | | **Zyra e Eksporteve** | Përgjegjës i Zyrës së Eksporteve | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 8 | IV-2 |
| | | **Zyra e Skanerit** | Përgjegjës i Zyrës së Skanerit | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Zyra e Terminalit të pasagjereve** | Përgjegjës i Zyrës së Terminalit të Pasagjereve | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Terminali i Trageteve** | Përgjegjës i Zyrës së Terminali i Trageteve | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 10 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | **Përpunimi i Anijeve** | Përgjegjës i Zyrës së Përpunimit të Anijeve | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 8 | IV-2 |
| | | **Terminali i Konteinerëve** | Përgjegjës i Zyrës së Terminalit të Konteinerëve | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 4 | |
| | | **Zyra kundër Trafiqeve (Task-Force)** | Përgjegjës i Zyrës kundër Trafiqeve (Task-Force) | C1 | 0 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | **Zyra e Akcizës Doganore** | Përgjegjës i Zyrës së Akcizës | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier Akcize | C2 | 4 | IV-2 |
| | | **Zyra e Regjimeve Doganore** | Përgjegjës i Zyrës së Regjimeve | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Doganier regjimesh | C2 | 10 | IV-2 |
| | **Sektori Doganor Porto-Romano** | | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | **Zyra Doganore Hidrokarburet** | Përgjegjës zyre/turni | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 18 | IV-2 |
| | | **Zyra Doganore MBM** | Përgjegjës zyre/turni | C1 | 2 | IV-1 |
| | | | Doganier | C2 | 8 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Durrës** | | | | | **134** | |
| **Dega Doganore Rinas** | | | Kryetar Dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës** | | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Sektori Operacional/Terminal | Përgjegjës sektori | B | 1 | III-2 |
| | | Përgjegjës Turni | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 29 | IV-2 |
| | Zyra Doganore/Cargo | Përgjegjës zyre/turni | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Rinas** | | | | **45** | |
| Dega Doganore Elbasan | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/Arkivist/Magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës Zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 4 | IV-2 |
| | Zyra Doganore RBH | Përgjegjës turni | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Elbasan** | | | | **24** | |
| Dega Doganore Qafëthanë | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës turni/përgjegjës pike | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 6 | |
| | | Doganier | C2 | 9 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | Zyra e Skanerit | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | Zyra Doganore Tushemisht | Përgjegjës turni/zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| **Totali i Degës Doganore Qafëthanë** | | | | **37** | |
| Dega Doganore Korçë | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | Zyra Doganore Goricë | Përgjegjës turni/zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| **Totali i Degës Doganore Korçë** | | | | **22** | |
| Dega Doganore Kapshticë | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës turni/zyre | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 6 | |
| | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 4 | IV-2 |
| | Zyra e Skanerit | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Kapshticë** | | | | **28** | |
| Dega Doganore Vlorë | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 4 | IV-2 |
| | Zyre Doganore Himarë | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 1 | IV-2 |
| | Zyra Doganore e Terminalit Bregdetar për Depozitimin e Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| **Totali i Degës Doganore Vlorë** | | | | **28** | |
| Dega Doganore Fier | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Magazinier | D1 | 1 | |
| | | Sekretar/arkivist | C3 | 1 | |
| | Zyra e Operacioneve Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | Zyra e Mbikëqyrjes Doganore | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 16 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| **Totali i Degës Doganore Fier** | | | | **33** | |
| Dega Doganore Berat | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | Zyra e administratës | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Specialist/jurist/borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Berat** | | | | **16** | |
| **Dega Doganore Kakavijë (Gjirokastër)** | | Kryetar dogane | A | 1 | II-1 |
| | **Zyra e administratës** | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | Përgjegjës turni | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 6 | |
| | | Doganier | C2 | 12 | IV-2 |
| | **Zyra e Skanerit** | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës turni/zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| | **Zyra Doganore Sopik** | Doganier | C2 | 0 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 0 | |
| **Totali i Degës Doganore Kakavijë (Gjirokastër)** | | | | **32** | |
| **Dega Doganore Sarandë** | | Kryetar dogane | B | 1 | II-2 |
| | **Zyra e administratës** | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Specialist/jurist borxhi | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra Doganore Qafëbotë** | Përgjegjës turni/zyre | C1 | 3 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 6 | IV-2 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 3 | |
| **Totali i Degës Doganore Sarandë** | | | | **28** | |
| **Dega Doganore Tri Urat (Përmet)** | | Kryetar Dogane | B | 1 | II-2 |
| | **Zyra e administratës** | Specialist/analize risku/aposterior | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Financier | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Sekretar/arkivist/magazinier | C3 | 1 | |
| | **Zyra e Operacioneve Doganore** | Përgjegjës turni | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier peshoreje/pike kontrolli | C3 | 2 | |
| | | Doganier | C2 | 3 | IV-2 |
| | **Zyra e Mbikëqyrjes Doganore** | Përgjegjës zyre | C1 | 1 | IV-1 |
| | | Doganier | C2 | 2 | IV-2 |
| **Totali i Degës Doganore Tri Urat Përmet** | | | | **13** | |
| **TOTALI I DEGËVE DOGANORE** | | | | **645** | |
| | | | | | |
| **TOTALI I ADMINISTRATËS DOGANORE** | | | | **1074** | |